

Letërsi e huaj bashkëkohore  
Olga Grjasnowa  
Zoti nuk është i ndrojtur  
DITURIA



Olga Grjasnowa

# Zoti nuk është i ndrojtur

Përktheu: Grejsa Ymeri-Boehl

Shtëpia Botuese DITURIA

Titulli origjinal:  
Olga Grjasnowa  
*Gott ist nicht schüchtern*

Redaktore: Mariana Ymeri  
Paraqitja grafike: Ulinda Selenica

© për përkthimin: S. Fischer Foundation by order of TRADUKI  
DITURIA, 2022

Botimi i kësaj vepre u mbështet financiarisht nga TRADUKI, një rrjet letrar ku bëjnë pjesë Ministria e Çështjeve Europiane dhe Ndërkombëtare e Republikës së Austrisë, Ministria e Jashtme e Republikës Federale të Gjermanisë, Fondacioni Zvicëran Pro Helvetia, Grupi i Interesit të Përkthyesve dhe Përkthyesve (Shtëpia e Letërsisë Vjenë) me porosi të Ministrisë Federale të Artit, Kulturës, Shërbimeve Publike dhe Sportit së Republikës së Austrisë, Instituti Goethe, Fondacioni S. Fischer, Agjencia Sllovene e Librit, Ministria e Kulturës dhe Medias e Republikës së Kroacisë, Ministria e Çështjeve Sociale dhe Kulturës e Principatës së Lihtenshtajnit, Fondacioni Kulturor i Lihtenshtajnit, Ministria e Kulturës e Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës dhe Informacionit e Republikës së Serbisë, Ministria e Kulturës e Rumanisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Kulturës dhe Sportit e Malit të Zi, Panairi i Librit në Lajpcig, Ministria e Kulturës e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ministria e Kulturës e Republikës së Bullgarisë.

traduki

Shtëpia Botuese DITURIA  
Rruga "Frederik Shiroka", Nr. 31, Tiranë  
P.O. Box 1441  
Tel.: + 355 4 2236 635; Cel.: + 355 692048503  
E-mail: sekretaria@dituria.al  
www.dituria.al  
 Shtëpia Botuese DITURIA

# Pjesa e parë



Liria është një folje.

Daniel Kahn





**N**ga dritarja e avionit nisin të dallohen fushat e para, ndjekur nga një det shtëpish që zhduken aty për aty, pastaj krahu i avionit luhatet për lart dhe përmes dritares nuk shihet veç bluja e qiellit. Krahu nis të ulet sërish dhe Hamudi sheh fushën e djegur nga dielli. Rrotat ulen keq në tokë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Damaskut s'ka ndryshuar pothuajse fare, që nga vizita e fundit e Hamudit. Brenda kabinave të shërbimit me bojë të leskëruar qëndrojnë të njëjtit punonjës turivarur të policisë kufitare. Kontrollonjë të zymtë pasaportën e tij dhe i kujtojnë se skadon pas pak ditësh.

“Prandaj jam këtu”, përgjigjet Hamudi. Polici i kufirit, me një uniformë që i rri keq, e lë të kalojë.

Hamudi është i lumtur që ndodhet në Siri, me gjithë dyshimet e tij: gjithë jetën i kanë mësuar se këtu s'ka të ardhme dhe se pas mbarimit të universitetit, do t'i duhej të emigronte në Kanada, Australi ose Europë. Vitet që kaloi në Siri, i kanë mbështetur dyshimet e tij.

Pret një kohë të gjatë për bagazhet. Disa familje të mëdha e humbasin durimin; fëmijët qajnë e ankohen; një zotëri thinjak ndez cigaren dhe paralajmërohet nga personeli mbikëqyrës; pastrueset shkojnë e vijnë me një ngadalësi të dukshme me kovat e tyre me ujë, pa pastruar asgjë. Kur drita e kuqe mbi tapetin transportues të bagazheve, më në fund llamburit, të gjithë grumbullohen te cepi i daljes së valixheve, për të fituar një pozicion strategjik të favorshëm. Në fund, dalin fitues dy burra flokëverdhë e me mjekër të kuqërremtë, që flasin me zë të lartë një gjermanishte të Zvicrës. Ndërsa tapeti transportues

vihet në punë, turma fillon e gumëzhin. Bagazhet rrëmbehen shpejt. Çanta, valixhe materialesh, bohçe, çanta shpine dhe kuti ngarkohen mbi shpatulla ose vendosen në karrocat e dorës dhe shtyhen me entuziazëm drejt daljes.

Në sallën e mbërritjeve, pas kordonit ndarës, një turmë njerëzish kërkon me sy të afërmit dhe miqtë, e nxitojnë drejt tyre, sapo hapet fare pak dera e zonës së marrjes së bagazheve. Një polic i paralajmëron herë pas here të mos i afrohen shumë derës. Brenda një kohe të shkurtër fytyrën ua përshkon shprehje gëzimi, kureshtjeje dhe shqetësimi. Disa fëmijë me tullumbace në dorë enden të hutuar, foshnja, baballarët e të cilëve tundin buqeta me lule në shenjë përshëndetjeje, fërkojnë sytë nga lodhja.

Edhe Hamudin e pret një turmë e zhurmshme. Në të vërtetë, mendonte të merrte një taksi direkt për në hotel. Donte të shijonte pak qetësi - nja dy net gjumë vetëm, larg nga Kleri dhe familja e tij, që e priste në Deir ez-Zor. Një pushim i vogël, vetëm, për veten. Ja pse nuk ua tha miqve kohën e mbërritjes në Damask. Ata e interpretuan heshtjen e tij si një harresë të thjeshtë dhe e kërkuan në internet orarin e mbërritjes. I hidhen në qafë dhe e puthin në faqe. E hipin Hamudin në makinë së bashku me valixhen e tij të rëndë plot me dhurata. Hamudi ka rezervuar një dhomë në Four Seasons, edhe pse s'ia mban xhepi. Vetëm disa javë më parë, kishte përfunduar në Paris shkëlqyeshëm specializimin për kirurgji plastike. Kishte punuar pesë vite me radhë për këtë moment dhe kur më në fund ai erdhi, iu duk se kishte bërë gjënë e duhur. Pastaj aplikoi në tre spitalet më të mira të qytetit dhe pa zgjatur shumë e thirrën në intervistë që të tre. Hamudi është shtatlartë, i hollë, i sjellshëm dhe simpatik. Frëngjishtja e tij është e përsosur. Megjithatë vendimtare qe simetria e përsosur e fytyrës së tij; ai ishte pikërisht njeriu që besojë se mishëronte standardet aktuale të bukurisë. Vendosi shpejt për

spitalin që i bëri ofertën më të mirë dhe e mori menjëherë me postë kontratën e punës. Po atë mbrëmje e festoi ngjarjen me Klerin, të dashurën e tij, me një darkë të shtrenjtë dhe shumë shampanjë. Më pas kishte organizuar udhëtimin për në Siri, sepse i duhej të rinovonte pasaportën - thjesht një formalitet, nga i cili varej leja e qëndrimit në Francë - dhe me këtë rast po bënte edhe një pushim të shkurtër.

Dysshemetë prej mermeri në hollin e Four Seasons shkëlqejnë nga pastërtia dhe dekore të shumta me lule përhapin një aromë të pakëndshme. Hamudin e kontrollojnë dy punonjës të sigurimit dhe mezi e lejojnë të hyjë, pasi nuk është i huaj. Miqtë e tij do të vijnë ta marrin përsëri pas rreth dy orësh, iu lut t'i jepnin pak kohë të merrte një sy gjumë e të bënte një dush. Dhoma e tij ka mobilim luksoz, shtrati është i gjerë dhe i fortë, çarçafët e sapohekurosuar shkëlqejnë nga bardhësia, minibari është plot dhe mobilet janë në stilin e Damaskut. Mbi tryezën e vogël është vendosur një buqetë e madhe me lule. Sidoqoftë aroma është më e mirë se dekorimi i luleve në sallë. Hamudi lë ujin të rrjedhë në vaskë dhe i bie numrit të Klerit.

Në mbrëmje del me miqtë. Një grup i zhurmshëm burrash e grash rreth të tridhjetë e pesave, disa tashmë të martuar, të tjerë të divorcuar ose thjesht *single*, homoseksualë apo njerëz që bashkëjetojnë pa asnjë lloj angazhimi të qëndrueshëm. Ata enden në qendrën e Damaskut, ndalojnë të pinë *arak* në ndonjë bar, porosisin meze të lehta, edhe më shumë *arak*, edhe më shumë ushqim. Qeshin, bërtasin, bëjnë thashetheme dhe debatojnë. Janë më të zhurmshëm se një herë e një kohë, sepse përpiqen të rigjejnë njëri-tjetrin, ta sigurojnë se gjithçka është si më parë, se vazhdojnë të jenë miq të mirë si dikur.

Hamudi përpiqet të gjejë ndonjë lidhje me jetën e miqve të tij, të ndjekë fillin e marrëdhënieve të tyre, fëmijët, punët e

tyre, por shpejt fillon t'i gumëzhijë koka. Ai nuk e di që grupi i dikurshëm i kohëve të fakultetit, është ritakuar vetëm për t'i bërë qejfin atij - që kur ai ka ikur, jetët e tyre kanë marrë rrugë të ndryshme.

Në fillim janë të gjithë si të kontraktuar, nuk dinë si të sillen me njëri-tjetrin, por pas një copë here të mirë fillojnë e ndihen më të çlirët dhe meritën më të madhe për këtë e ka alkooli. Kujtojnë ngjarje të rinisë, hedhin e presin emra të njohurish, sheshesh dhe rrugësh që Hamudit mezi i kujtohen.

Edhe Damasku është pothuajse i panjohur për të. Këto pesë vjet, qendra e qytetit është transformuar: dyqanet e vogla ushqimore duheshin mbyllur, për t'i çelur përsëri dyert si Zara ose Benetton; furrat e bukës ua kanë lënë vendin kafeneve ku shërbehen kapuçino me qumësht soje me çmime europiane; dyqanet e dikurshme ku mund të blije gjithçka, që nga kaçavidat deri te bidonët e benzinës, ua kanë lënë vendin dyqaneve të celularëve.

Në dritën e parë të agimit, Hamudi shtrihet në shtratin super të shtrenjtë të hotelit të tij dhe e zë gjumi në çast, ndërsa nga dritaret e hapura hyjnë mallkimet e të dehurve të natës dhe kënga e hoxhës që fton për lutjen e mëngjesit.

**A**mali përpiqet të largojë frikën. Gjatë gjithë jetës ka studiuar njerëzit përreth, familjen, miqtë, të dashurit, të panjohurit. I ka ngulitur në mendje mimikat e tyre, gjetet e tyre, për t'i riprodhuar më vonë me saktësi në skenë. Ka mësuar personazhe, tone zëri dhe emocione. Që e vogël, e para se të mësonte të fliste, imitonte njerëzit. Sidoqoftë, për një kohë të gjatë ajo nuk ia pohonte as vetes dëshirën për t'u bërë aktore. Mendonte se nuk ishte e talentuar dhe e bukur sa duhej për të dalë në skenë. Ijët e saj i dukeshin shumë të gjera, hunda shumë e gjatë, kurse zëri jo aq i fortë. Veç kësaj, i ati i thoshte vazhdimisht se kjo s'ishte punë për gra të nderuara. Kësisoj, Amali në fillim u diplomua për letërsi angleze, por librat nuk e mbushnin, ndaj një ditë të bukur u paraqit në audicionet e Institutit të famshëm të Arteve Dramatike.

I duket se ka kaluar shumë kohë që atëherë. Dhe frika ka zënë vend në gjoksin e saj si një parazit. Amali e di mirë çfarë mund t'i ndodhë, por ajo s'e di nëse dhe kur do të ndodhë, dhe kjo pasiguri i fut të dridhurat. Shumë njerëz nga rrethi i saj arrestohen, torturohen ose thjesht *zhduken*, që është e njëjta gjë.

Damasku është një qytet i zhurmshëm, i rrëmujshëm dhe i ethshëm, i tejngopur me boritë e taksive dhe autobusëve, britmat e shitësve ambulantë, gumëzhimën dhe pikimin e kondicionerëve në fasadat e shtëpive, të gjitha të bashkuara me zhurmën e muzikës që vjen nga xhamat e makinave e bareve. Në Damask njeriu mund të zhytet në historinë dhe superlativat e tij. Megjithatë, qyteti sot është zhytur në një

heshtje fantazmë. Nuk ka trafik, nuk ka biseda, nuk dëgjon as edhe një pëshpëritje. Qielli është i mbuluar me re gri.

Amali sheh vazhdimisht agjentë të shërbimeve sekrete, ndërsa trupi i saj regjistron çdo lëvizje dhe zhurmë të tyre. Perdja e njëres prej dritareve të godinës përballë, lëviz. Një grua e moshuar përpiqet të përgjojë pa u vënë re përmes pëlhurës së rëndë të damaskut dhe në atë moment Amali vendos që s'do të fshihet më kurrë pas një perdeje, as sot, as nesër e as pas dyzet vjetësh, dhe se e vetmja mënyrë për ta arritur këtë është të qëndrojmë në këtë vend, çfarëdo që të ndodhë.

Demonstrata e parë u zhvillua dy ditë më parë. Që pas dimrit, ishte hera e parë që ajri ndihej i butë e pothuajse i ngrohtë. Amali eci bashkë me disa miq drejt ndërtesës së parlamentit, me pankarta kartoni në format A4 në duar. Fytyrën e mbuloi mirë me shall. Nuk guxuan të merrnin pankarta të mëdha plastike. Në fund të demonstratës u shpërndanë menjëherë, pa e parë njëri-tjetrin në sy. U vinte turp që ia mbathnin fshehurazi pas një demonstrate, ndërsa në vende të tjera njerëzit i vënë flakën vetes.

Në ditët e para të revolucionit, optimistët mendonin se mediat ndërkombëtare dhe Al Jazeera do të raportonin për demonstratat e tyre. Mendonin se komuniteti ndërkombëtar nuk do t'i braktiste, derisa demonstruesit mëtonin nga shteti i vet atë që, me sa dukej, kërkonte edhe pjesa tjetër e botës. Askush, në të vërtetë, nuk mendonte për përmbysjen e regjimit - thjesht të ndërmerreshin reforma. Disa lëshime të vogla nga diktatori.

Në fakt, njerëzve u kishte ardhur në majë të hundës prej tij. Amalit i kishte ardhur në majë të hundës, vëllait të saj i kishte ardhur në majë të hundës, miqve, shokëve të saj të shkollës, të njohurve, të panjohurve në rrugë, shoqërisë vulgare boheme i kishte ardhur në majë të hundës. U kishte

ardhur në majë hundës korrupsioni, arbitrariteti i shërbimeve sekrete, pafuqia e vet dhe poshtërimi i vazhdueshëm. U kishte ardhur në majë të hundës që të gjitha bibliotekave publike, aeroporteve, stadiumeve, universiteteve, parqeve e madje edhe kopshteve, u vihej emri Asad. U kishte ardhur në majë të hundës fakti që baballarët, vëllezërit dhe xhaxhallarët e tyre po kalbeshin në burgje. U kishte ardhur në majë të hundës që duhej të mblidhnin para për të blerë përjashtimin nga shërbimi ushtarak për djemtë, ndërsa në televizionin kabllor adoleshentët amerikanë merrnin nga prindërit si dhuratë makinë, me të cilën mund të udhëtonin nëpër botë. U kishte ardhur në majë të hundës nga detyrimi për të kënduar me zë të lartë çdo mëngjes në shkollë *Asadi përjetësisht* dhe betimi për të luftuar kundër të gjithë amerikanëve, sionistëve dhe imperialistëve. U kishte ardhur në majë të hundës që në lëndën e Edukimit Politik duhej të mësonin përmendësh citate të Asadit dhe në detyrat e klasës të plotësonin fjalët që mungonin dhe t'i rendisnin në mënyrë kronologjike. U kishte ardhur në majë të hundës që në orën e Stërvitjes Ushtarake u mësonin si të çmontonin dhe rimontonin një pushkë. U kishte ardhur në majë të hundës që trajtoheshin si kafshë. Dhe mbi të gjitha ishin të lodhur që s'ishin në gjendje t'i thoshin të gjitha këto me zë të lartë.

Brezi i Amalit është i pari që nuk njih gjë tjetër veç pushtetit totalitar të klanit Asad, ndryshe nga prindërit dhe gjyshërit e tyre, të cilët mbanin mend mirë puçet e pafundme, para marrjes së pushtetit nga Hafiz al-Asadi dhe masakrës së Vëllazërisë Myslimane më 1982 në Hama, me të cilin qeveria kishte treguar qartë se me të s'bëhej shaka. Që atëherë regjimi i Asadit paraqitet si shprehje e vullnetit hyjnor. Ose më shumë: Bashar al-Asad është më i madh se Zoti, të paktën kështu sugjeron gjithë prania e tij, ajo e babait të tij, e vëllezërve, e gruas dhe e tre fëmijëve, qoftë në formën e portreteve të varura

në çdo cep të vendit, si dordolec për të frikësuar njerëzit dhe për t'i bërë t'ia mbathin.

Me bisht të syrit, Amali sheh aktoren e njohur alevite Fadva Soliman, të cilën ka kohë që e admiron, dhe për një hop pamja e saj e qetëson. Mbushet me frymë thellë dhe me dorën e djathtë kap të majtën, që të ndalojë dridhjen. Askush nuk e ka idenë se çfarë do të ndodhë. Ndoshta regjimi do t'u japë një dënim shembullor demonstruesve kësaj here, do t'i arrestojë të gjithë ose do ta shpërndajë turmën me dhunë.

Pas një copë here të mirë, gjatë së cilës demonstruesit veçse qëndrojnë së bashku, pa bërë gjë tjetër, dhe vëzhgojnë njerëzit e shërbimeve sekrete, një burrë trupvogël me një xhaketë lëkure që i rri e madhe, largohet nga turma dhe shkon në kafenenë më të afërt. Është një nga artistët më të rëndësishëm sirianë. Amali dhe rreth njëzet njerëz të tjerë e ndjekin si një turmë fëmijësh kopshti, të lehtësuar që i kanë shpëtuar rrezikut.

“Al Raouda”, që ka kuptimin “Kopshti i Edenit”, është një bar tradicional i Damaskut që shërben alkool dhe ushqime të lehta dhe frekuentohet kryesisht nga kundërshtarët e qeverisë, homoseksualët, lesbiket, të rinjtë e dashuruar dhe kriminelët e vegjël. Demonstruesit mblidhen te Kopshti, i cili është i veshur me mermer të bardhë dhe bojë kafe dhe herë pas here duket si parajsë. Diskutojnë hapur, edhe pse në një mënyrë krejtësisht hipotetike, për lëshimet që mund të bëjë regjimi dhe flirtojnë ashiqare me njëri-tjetrin. Pasi përshëndet një për një të gjithë të njohurit, Amali shkon në banjë, lë ujin e ftohtë t'i rrjedhë mbi kyçet e duarve, spërkat fytyrën me të, mbushet thellë me frymë dhe e nxjerr përsëri. I dridhet i gjithë trupi, ndërsa fillon të çlirohet nga tensioni. Habitët që demonstrata shkoi kaq qetë. Amali nuk është ndier kurrë pjesë e një grupi, por për herë të parë kjo ide nuk i duket e pakëndshme.